

URDHËR
Nr. 438, datë 26.12.2019

**PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, LICENCIMIT DHE PUBLIKIMIT NË MËNYRË
ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionin e Këshillit të Ministrave; të ligjit nr. 131/2015, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, të nenit 70/2 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, të pikës 4, të nenit 36, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9880, datë 2.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”; VKM nr. 391, datë 3.5.2017, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”, vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Nga data 1.1.2020, shërbimet funksionale të QKB-së të përcaktuara në tabelën 1, lidhur me regjistrimin dhe licencimin e biznesit, do të ofrohen vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik në portalin e-albania, në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, ligjin për licencimin e biznesit, ligjin për nënshkrimin elektronik dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

2. Shërbimet funksionale të QKB-së të përcaktuara në tabelën 2, lidhur me regjistrimin dhe licencimin e biznesit, do të ofrohen vetëm në mënyrë elektronike, nëpërmjet sportelit elektronik, nga data 30.6.2020.

3. Kushtet, procedurat për kryerjen e aplikimeve pranë regjistrimit tregtar, nëpërmjet sportelit elektronik, shqyrtimi i tyre nga QKB-ja, si dhe afatet e tyre janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 391, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

4. Kushtet dhe procedurat për kryerjen e aplikimeve për pajisjen me licence dhe leje që trajtohet nga apo nëpërmjet QKB-së, pranë Regjistrimit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nëpërmjet sportelit elektronik, si dhe procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, janë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitave ligjore në fuqi.

5. Për aplikimet për pajisjen me licence dhe leje që trajtohet nga apo nëpërmjet QKB-së, pranë Regjistrimit Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, nëpërmjet sportelit elektronik, aplikanti pasi verifikon se të dhënat e plotësuara në formular dhe dokumentet shoqëruese të ngarkuara në dosjen elektronike janë të sakta, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet, që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe legjislacionit sektorial për licencimin, i konfirmon ato me mjete elektronike që garantojnë autenticitetin e origjinës dhe pacënueshmerinë e përmbajtjes së dokumenteve në format elektronik, të paktën nëpërmjet nënshkrimit elektronik të kualifikuar të formularit të aplikimit, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik.

6. Kushtet dhe mënyrat e pajisjes së individëve me të drejtat përkatëse të aksesit elektronik, procedurat e tyre, kushtet e sigurisë dhe të ruajtjes së komunikimeve elektronike, do të bëhet në përputhje me kreun IV, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë; VKM nr. 391, “Për përcaktimin e procedurave të regjistrimit dhe të publikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe akteve ligjore dhe nënligjore për nënshkrimin dhe dokumentin elektronik.

7. Vërtetimi i dokumenteve elektronike, të lëshuar nga QKB-ja do të ofrohet në përputhje me ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”; ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik” dhe akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe zbatim të tyre.

8. Qendra Kombëtare e Biznesit në bashkëpunim me AKSHI-n do të kryej njoftime publike lidhur me rastet e remonteve të planifikuara apo të incidenteve teknike të sportelit elektronik dhe të rasteve të ndërhyrjeve të paautorizuara, referuar vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar dhe akteve të nxjerra në zbatim të tyre.

9. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Biznesit për zbatimin e këtij urdhri.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj